

UNITED NATIONS
United Nations Interim
Administration Mission
in Kosovo



NATIONS UNIES
Mission
d'Administration
Intérimaire des Nations
Unies au Kosovo

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

KOMISIONI PËR BUJQËSI, PYLLTARI,
ZHVILLIM RURAL, MJEDIS DHE PLANIFIKIM
HAPËSINOR

Procesverbal Nr. 64
nga mbledhja publike e mbajtur më 3.4.2007
kryesuar nga **Lulzim Zeneli**-nënkryetar i komisionit
DËGJIMI PUBLIK

Debati filloi në orën 12,45

Të pranishëm :	8. Afrim ARZUALLXHIU
1. Rifat KRASNIÇ kryetar	9. Xhelal CANZIBA
2. Lulzim ZENELI nënkryetar-I-	10. Fetah BERISHA
3. Jusuf SUTAJ	11. Gazmend MUHAXHERI
4. Shaban HALIMI	12. Selvije HALIMI
5. Zyhrrie MALOKU	Munguan :
6. Berat LUZHA	13. Goran BOGDANOVIĆ -nënkryetar-II-
7. Sadudin BERISHA	14.

TË FTUARIT : Nga MMPH , përfaqësuesit e disa Komunave të
Kosovës, Xhelal Llonçari etj

**Shqyrtimi i projektligjit për ndryshimin dhe
plotësimin e LPH**

Kryesuesi Lulzim Zeneli në fillim përshëndeti anëtarët e komisionit dhe mysafirët e ftuar të cilëve iu sqaroi dilemat të cilat janë shfaqur në komision lidhur me këtë projekt. Ai kërkoi nga të pranishmit një debat të hapur dhe

konstruktiv që do të ndihmoj komisionin në punën e mëtejme rreth shqyrtimit të këtij projektligji.

Merxhan Abdyli vërejti se përfaqësuesit e komunave shumë pak janë përgjigjur këtij debati çka tregon për mosorganizimin ndërmjet MMPH dhe komunave. Ai theksoi se MMPH krejt atë çka ka deshtë të thotë e ka thënë përmes këtij projekti, ndaj shprehu gatishmërinë për dëgjimin e vërejtjeve nga të ftuarit dhe anëtarët e komisionit.

Xhelal Llonçari falënderoi për ftesë dhe theksoi se pas analizës së shkresave të dërguara për këtë dëgjim ka ardhë në përfundim si vijon: nuk ka njohuri sa është arrit nëpër komuna realizimi i planeve hapësinore (neni 11), neni i cili konfirmon mundësin e dy apo më tepër komunave të hartojnë një plan duhet të precizohet (me pëlqimin paraprak të MMPH apo si do të bëhet kjo punë), në këtë projekt janë dy terma prej të cilave vetëm njëra duhet të mbetet sepse dallohen (plani urbanistik dhe plani urban), radhitja tek neni 23 duhet të bëhet duke cekur së pari Kosovën e pastaj komunat e jo e kundërta ashtu si është, definicioni për fshatin është e paqëndrueshme, poashtu edhe për vendbanimet joformale, qytetin, vija rregullative (vijë kjo e cila duhet të ndaj hapësirën e jo të drejtën), leja urbanistike (shprehje kjo që nuk i takon urbanizmit).

Ramadan Krasniqi – Prizren shprehu habinë se për çfarë po bëhen këto ndryshime nga MMPH, ngase këto ndryshime sipas tij kanë përmbajtje më tepër teknike. Nuk kuptohet sidomos qasja e MMPH ku disa përkufizime në këtë projekt nuk janë në ligjin më parë të miratuar, dmth për diçka të re duhet të epet arsyetimi për zgjedhjen e atij problemi, p.sh. vendbanimet joformale janë lagje të varfra, lagje të cilat janë pasojë e luftës së fundit por ato njëkohësisht janë pjesë e lagjeve kryesore të cilat duhet të rregullohen me këtë draft. Nëse shikohet neni 6, vazhdoi ai, MMPH ma tepër ka kontribuu me udhëzime administrative se sa me këto tri paragrafë që iu kanë shtua këtij neni. Neni 8 nuk rregullon qartë çështjen se kush duhet ta jap provimin profesional. Ai përfundoi me konstatimin se ky projekt nuk hyn në çështjet substanciale.

Përfaqësuesi i Drejtorisë së Urbanizmit-Gjilan u pajtua me vërejtjet e cekura sepse projektligji më tepër mirët me çështje teknike. Ai konstatoi se më elementare është të ndërrohet Ligji për ndërtimin dhe tokën ndërtimore, ngase si tha ai, më mirë është një ligj të rregulloi këto çështje se sa tri ligje parciaisht e asnjëra si duhet.

Merxhan Abdyli kërkoi nga bashkëpunëtorët të japin përgjigje në pyetjet e parashtruara. Përfaqësuesja nga MMPH sa i përket pyetjes së z. Krasniqi për vendbanime joformale theksoi se shpjegimi për vendbanimet joformale epet në nenin 22.2 dhe shtoi se kemi të bëjmë me një ligj kornizë e jo detal, këto gjëra, vazhdoi ajo, do të rregullohen me plan afat mesëm dhe afat gjatë. Ajo nuk u pajtua me konstatimin se asgjë nuk bëhet me këtë ligj, sepse pas miratimit të tij do të nxirren aktet plotësuese për zbatimin e tij. Provimin profesional, shpjegoi ajo rreth vërejtjes tjetër, duhet ta japin personat akademik, por nuk është e obliguar të kenë edhe titullin akademik. Përfaqësuesja tjetër e MMPH sqaroi se planin zhvillimor dhe urban të një komune mund ta hartoi vetëm një komunë, por nuk përjashtohet bashkëpunimi. Ndryshim substancial megjithatë ka në këtë projekt ngase precizohet kompetenca lidhur me lejen urbanistike, ndërsa cili term do të

aplikohet (urbanistik apo urban) do të vendos komisioni parlamentar, pra ai që jep lejen për ndërtime urbanistike do ta jap edhe lejen urbanistike, gjithashtu hartuesit e planit nuk do të mund të jenë njëkohësisht edhe anëtarë të këshillit. Definicioni për vendbanime joformale , vazhdoi ajo, është marr nga kushtet që dominojnë në Kosovë por edhe nga deklaratat e Vjenës.

Xhelal Llonçari duke ju kundërvu deklaramit të përfaqësueses së MMPH theksoi se me ligj nuk lejohet të mendohet por duhet të saktësohet dmth vendbanimet joformale në këtë projekt kanë një definim të paqëndrueshëm. Ai nuk ishte i kënaqën me përgjigjen lidhur me dy komuna të cilat mund të hartojnë një plan.

Gafur Ilazi-Ferizaj u pajtua se vendbanimet joformale nuk kanë definimin adekuat me këtë projekt, pastaj neni 16.6 nuk precizon si mund të mirët iniciativa, neni 27.3 duhet të parasheh ankesën kundër organit të kuvendit komunal, përndryshe ku të bëhet kjo ankesë. Përfaqësuesja e MMPH reagoi dhe sqaroi se neni 26.4 parasheh konfliktin administrativ.

Lulzim Zeneli falënderoi për këto sqarime dhe iu dha fjalën anëtarëve të komisionit.

Selvije Halimi theksoi se nga diskutimet e sotme po shohim se nuk qenka pengesë ligji i cili po tentohet të ndryshohet. Pasi që profesori Llonçari shpjegoi se termi leja urbanistike nuk ka të bëjë me urbanizëm pyeti se kjo leje a duhet të quhet pëlqim urbanistik apo si. Ajo vazhdoi me konstatimin se këto ndryshime po u bëkan vetëm për shkak të vendbanimeve joformale dhe lejes urbanistike ndaj ajo theksoi se sqarimi duhet të epet edhe për kandidatët e provimit profesional se kush mund të jenë ata (çka nënkuptohet me studime master) dhe kush mund ti licencoj ata.

Shaban Halimi përshëndeti përpjekjet e sotme për sqarimin e dilemave dhe propozoi që këto sqarime ti dërgohen komisionit edhe me shkrim dhe në bashkëpunim me MMPH të kompletohen.

Berat Luzha potencoi faktin se ndryshimi i një ligji me 19 nene është pak e tepërt, ndaj sugjeroi ose të nxirret një ligj i ri ose kështu nuk bënë. Ai mori shembull definicionet në këtë projekt të cilat nuk ndryshojnë rrënjësisht nga LPH , krejt varet prej asaj se sa është duke u zbatuar LPH, përndryshe nëse bëhet ndryshimi i tij , ai bëhet në dy tri nene e assesi në këtë mënyrë, përfundoi ai.

Zyhrie Maloku kundërshtoi sqarimin e përfaqësueses së MMPH rreth vendbanimeve joformale ngase neni 22.2 nuk ka të bëjë me shpjegimin se çka janë ato.

Gazmend Muhaxheri bëri një krahasim në mes të pakënaqësisë së komunave dhe periudhës kohore (4 vjet) brenda së cilës nuk kanë bërë vërejtje në këtë ligj, ndaj pyeti përfaqësuesit e komunave ku e shohin veten si subjekt në këtë ligj si bartës të planeve.

Sadudin Berisha një gjë desh të sqaroi : funksionalitetin e një ligji, mungesa e së cilës është pasojë e mungesës së praktikave të hartimit të ligjeve te ne. Një ligj fare nuk duhet të ketë përkufizime sepse ato nuk paraqesin norma juridike (nuk obligojnë), ndaj ligjit doemos duhet ti bashkëngjitet aneksi me komente zyrtare. Në mungesë të këtyre komenteve nga sponzorizuesi shpesh ndodhë që edhe hartuesi nuk është i saktë (i qartë). Duke aluduar në hartimin e projektligjeve ai përfundoi me konstatimin se “gjithçka çka na vjen prej Evropës nuk duhet ta

marim gjithmonë si më të mirë” në kuptimin pozitiv. Ai propozoi që herëve tjera projektet të përcillen në procedurën parlamentare me komente, ngase norma juridike para së gjithash duhet të komentohet nga përfaqësuesi legal.

Jusuf Sutaj tha se ky projekt ka ardh në parlament si ligj i ri dhe se aksidentalisht ka kalua në leximin e parë. LPH në vitin 2003 është miratua pa plan hapësinor kurse tani kemi planin por jo të plotë, ndaj kërkoi që konceptet dhe definicionet të jenë të sakta, njëherit kërkoi nga profesori Llonçari ti sjell komisionit definicionin për vendbanimet joformale, pasi që u deklarua lidhur me këtë sqarim.

Xhelal Canziba kundërshtoi nenin 32 në bazë të cilës tani komunave duhet ti epen edhe nga 18 muaj për hartimin e planeve çka do të thotë se shkuan 4 vite dhe asgjë.

Vjosa Vela reagoi lidhur me ngatërrimin nga anëtarët e komisionit të termit vendbanime joformale me ndërtimet ilegale.

Selvije Halime tha se kjo është ofenduese nga përfaqësuesja e MMPH sepse anëtarët e komisionit dëshirojnë vetëm definime të qarta në ligj, MMPH është ajo që dëshiron ti heq dilemat me këto ndryshime. Ajo kategorikisht mohoi se një dilemë e tillë është shfaqur nga anëtarët e komisionit, gjithashtu kundërshtoi anëtarin e komisionit i cili tha se “aksidentalisht ka kaluar ky projekt në leximin e parë” duke theksuar se pikërisht është e kundërta e këtij konstatimi.

Lulzim Zeneli konstatoi se dëgjimi publik i sotëm përkundër rrjedhës së debatit mjaft kontribuoi në eliminimin e dilemave të shfaqura në komision, ndaj përfundoi debatin me falënderime.

Debati publik përfundoi në orën 13,45

Kryesuesi ,
Lulzim Zeneli

Pasi që mysafirët e ftuar liruan sallën, kryetari i komisionit **Rifat Krasniç** ftoi anëtarët e komisionit ti zgjedhin ca çështje me rëndësi për komisionin, ndaj ia dha fjalën :

1. **Shaban Halimit** i cili njoftoi komisionin se në takimin e inspektorëve komunal në Istog më 28.3.2007 organizuar nga Asociacioni i komunave të Kosovës (AKK), është sugjeruar që grupit punues që trajton ndërtimet pa leje ti bashkëngjiten edhe dy anëtarë, njëri nga Deçani dhe tjetri nga Mitrovica.

Selvije Halimi shprehu mospajtimin me sugjerimin nga AKK ngase komunat mund të dërgojnë vërejtjet me shkrim nëse janë të interesuar, përveç kësaj ajo vuri në dukje faktin se “komunat gjithmonë po ankohen, ndërsa kur po ballafaqohemi asgjë nuk po flasin”.

Lulzim Zeneli konsideroi se zj. Halimi ka të drejt ngase komunarët janë të vetëdijshëm për gjendjen (kaosin) e krijuar , ndoshta vetë ata janë që e kanë krijuar atë (këtë gjendje), ndaj me rastin e ftesës nëpër institucione nuk janë mjaft efikas.

Komisioni nxori :

P Ë R F U N D I M

Nuk ka nevojë të zgjerohet Grupi punues 8 anëtarësh i këtij Komisioni i themeluar më 20.2.2007 për shqyrtimin e projektligjit për Trajtimin e Ndërtimeve pa leje.

2. Berat Luzha njoftoi komisionin me bisedën e tij që ka bërë me ambasadorin e Shqipërisë për një vizitë Parlamentit të Shqipërisë rreth problemeve aktuale në këtë komision dhe shkëmbimit të përvojave në këtë drejtim.

Stafi u obligua të hartoi shkresën e kërkuar nga përfaqësuesi i ambasadës së Shqipërisë, bashkërisht me deputetin Berat Luzha i cili edhe do të angazhohet rreth dorëzimit të kësaj shkrese në përfaqësinë e Shqipërisë në Prishtinë.

3. Lulzim Zeneli njoftoi komisionin me iniciativën e OSBE-së që të ndihmoi këtë komision duke ofruar një zyrtarë (hapjen e zyrës në Kuvendin e Kosovës) vetëm për çështjet e këtij komisioni, sidomos në lëmin e mjedisit.

Përfaqësuesi i OSBE-së do ti ofroi një dokument zyrtarë këtij komisioni me çka do të konsiderohet fillimi i këtij bashkëpunimi. Në kuadër të kësaj, vazhdoi ai , gjatë muajit shtator parashihet një konferencë ndërkombëtare për çështjen e Mjedisit në Kosovë, iniciativë kjo që do të jetësoi bashkëpunimin konkret.

Komisioni mirëpriti këtë bashkëpunim.

Zyrtari i lartë ligjorë,
Bajram Badivuku

Kryetari i Komisionit,
Rifat Krasniç

